



Permbledhje joteknike e aktiviteve

“Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne
qiell te hapur dhe nga guroret”

”Minierat nentokesore dhe veprimtarite e lidhura me to”



Subjekti: “Dushi” sh.p.k

Vendndodhja: Objekti "Maja e Gjeprave", Galeria Nr. 3, Vendburimi "Liqeni i Sopave", Bater, Bulqize, Diber.

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” shpk



Tirane, 2023

PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit ”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « PerLejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administriminmjedisor tembetjeve tengurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajritngandotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruartembetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes seveprimtarive qendikojne nemjedis per tecilat kerkohetlejemjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largiminpublik tembeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 «Per detyrat e organevemjedisore per tesiguarpjesemarrjen e publikutdhe te OJF-vevjedisore neprocesin e vleresimit tendikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Permiratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisit tetipaveA,Bdhe C per transferimin e lejevenganjesubjekt te tjetri, tekushteve per lejetrespektive temejdisit si dherregullave tehollleshme per shqyrtimin e tyrengaautoritetekompetentederi neleshimin e ketyrelejevenga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti **"Dushi" sh.p.k** me administrator **Z. Admir Koka** është regjistruar pranë QKB me NIPT **K47220404G** për ushtrimin e aktivitetit **"Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret"** dhe **"Minierat nentokesore dhe veprimtarite e lidhura me to"**. Aktiviteti zhvillohet në Objekti "Maja e Gjeprave", Galeria Nr. 3, Vendburimi "Liqeni i Sopave", Bater, Bulqize, Diber. Me përgatitjen e dokumentacionit përkatës subjekti kërkon të pajiset me Vendim të VNM-se se thelluar sipas Ligji 12.2015 datë 26.02.2015 **"Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011" Per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** dhe VKM nr. 686 datë 29.7.2015, **"Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afatëve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore.**

a) Pershkrimi i qëllimit të propozuar

Subjekti **"Dushi" sh.p.k** me administrator **Z. Admir Koka** është regjistruar pranë QKR me NIPT **K47220404G**. Vendi i ushtrimit të aktivitetit është Objekti "Maja e Gjeprave", Galeria Nr. 3, Vendburimi "Liqeni i Sopave", Bater, Bulqize, Diber. Subjekti ushtron aktivitetin Shfrytëzim i kombinuar karriere dhe minere e kromit. Aktiviteti merr në konsideratë masat e nevojshme për të siguruar që menaxhimi i tyre të kryhet pa demtuar shëndetin e njeriut dhe pa i sjell dëm mjedisit vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe për ujë, ajër, tokë, floren ose faunën
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat
- Pa demtuar peisazhin

Një synim tjetër është të përcaktoje e rekomandoje masat teknike organizative për zbatimin e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit, të punonësve njëzë të profesioneve të ndryshme si:

- teknolog
- manovrator
- shoferit
- punëtorit të thjeshtë.

Për të krijuar një ambient pune optimal dhe mbrojtjen nga aksidentet, shoqëria ka pajisur të gjithë punonjësit që punojnë në prodhim me uniformë, kapele mbrojtëse dhe me mjete mbrojtëse ndaj pluhurit dhe faktorëve të tjerë. Numri i punonjësve deri në 5 punonjës ose dhe me shumë nese do të jete te nevojshem.



Gjurma e "Dushi" sh.p.k.

<https://geoportal.asig.gov.al>
Data e Printimit: 16.05.2023.

522160.800
458764.800

524008.200
458764.800



522160.800
458764.800



524008.200
458764.800

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 125 250 500 m

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH

Nr.	X	Y	Z
1.	4589438	4439840	+1682
2.	4589400	4439970	+1682
3.	4588890	4440200	+1682
4.	4588890	4440280	+1682
5.	4588800	4440280	+1682
6.	4588800	4440400	+1682
7.	4588600	4440400	+1682
8.	4588600	4440279	+1682
9.	4588305	4440420	+1682
10.	4588273	4440447	+1682
11.	4588296	4439904	+1682
12.	4588330	4439770	+1682
13.	4588420	4439770	+1682
14.	4588420	4440200	+1682
15.	4588600	4440200	+1682
16.	4588800	4440122	+1682

Sipërfaqja totale e sipas Lejes Minerare me Nr. 946/1 është 0.228 km².

Objekti “Maja e Gjeprave”, është një objekt i zbuluar nga subjekti privat “DUSHI” Sh.p.k. krejt rastesisht. Disa copa kromi të takuara afër daljes, me sa duket të shkeputura nga trupi xeheror gjatë kryerjes së punimeve ushtarake para viteve 90-te, cuan të kjo dalje. Të keshilluar edhe me specialiste gjeologe, filloi pastrimi dhe në thellësi, u zbulua një dalje me gjatësi 25-30 m, me shtrirje VP-JL, trashësi 2.5 m.

Me punimet e mëvonshme (me të fundit), kryesisht, disa kanale kryq shtrirjes, u arrit të fiksohet kendi i rënies $70-75^\circ$ dhe rënia jugperendimore, si dhe kendi i zhytjes $25-30^\circ$ dhe zhytja juglindore.

Per terrenin në të cilin është fiksuar kjo dalje, konfiguracionin dhe elementet e saj, mendimi është që ky mund të jetë një trup kromi tubor, i cili duhet të zhytet edhe në thellësi.

Dalja është fiksuar në Piken Nr.1 në veriperendim, rreth kuotes +1761 dhe në Piken Nr.2 në juglindje, rreth kuotes +1758. Për momentin, për të mos rrezikuar shumë, mendojmë se kjo dalje do të ketë siguri deri në +1740. Terreni në lejon që pjesa +1740÷+1760 të shfrytëzohet me karriere. Këto rezervë në i vlerësojmë të kategorisë B, me 80% koeficient vërtetësie dhe pasht +1740 edhe për 10 m disnivel vertikal, llogarisim rezervë C_1 me 70% koeficient vërtetësie.

Metoda e llogaritjes së rezervave të perdorur, është ajo e prerjeve horizontale cdo 10 m. Madhësia e sipërfaqes së prerjeve të trupit në horizont të shumezuar me gjatësinë e prerjeve të trupit gjatë rënies dhe peshën volumore, pranuar për rastin 3.8 ton/m^3 , në jep sasinë e rezervave gjeologjike për cdo horizont.

Konkretisht, sipërfaqja e trupit të prerjeve me plane horizontale është 75 m^2 . Gjatësia e prerjeve +1740÷+1760, për kënd zhytje 30° të trupit është 40 m. Pështa volumore 3.8 ton/m^3 . Rezervë të kategorisë B = $62.5 \times 36 \times 3.8 = 8.550$ tone, të lokalizuara ndërmjet +1740 dhe sipërfaqe.

Rezervë të kategorisë C_1 +1740÷+1730, llogariten me të njëjtin arsyetim 3560 tone. Gjithësej, llogariten rreth 12.110 tone rezervë të kategorive B+ C_1 me 45% Cr_2O_3 në bllok.

Rezervat e nxjerrëshme

Në pjesën e mësipërme është bërë llogaritja e rezervave të pritëshme të kromit në këtë dalje, bazuar në të dhënat e marra nga punimet gjeologjiko-zbuluese, të kryera për vlerësimin e objektit të mineralizuar. Sa me sipër, janë llogaritur rezervë të kategorisë B=8550 tone dhe C_1 =3560 tone.

Duke patur parasysh se rezervat e kategorisë B ndodhen mbi horizontin +1740 dhe do të shfrytëzohen me karriere dhe rezervat e kategorisë C_1 ndodhen ndërmjet horizonteve +1730 e +1740 dhe do të shfrytëzohen me nentokë, është kryer llogaritja e rezervave të nxjerrëshme si më poshtë:

$$R_n = R_{kon} \left[\frac{(1-h)}{(1-v)} \right] \text{ ku:}$$

R_n - rezervat e nxjerrëshme në ton

R_{kon} - rezervat e konvertuara në ton

h – humbjet, 0.05

v - varferimi 0.05

Rezervat e konvertuara janë llogaritur duke patur parasysh kategorinë e rezervave gjeologjike. Për rastin e kategorisë B, koeficienti i konvertimit merret 0.8 (dmth janë 80% të sigurta), ndërsa për rastin e kategorisë C_1 koeficienti i konvertimit merret 0.7.

Atëherë, rezervat e nxjerrëshme me karriere, do të jenë:

$$R_n = 8550 \times 0.8 \times [(1-0.05)/(1-0.05)] = 6840 \text{ tone}$$

Per varferim 5%, gjate shfrytezimit me karriere, cilesia ne dalje do jete:

$$45 \times 0.95 = 42.7\% \text{ Cr}_2\text{O}_3$$

Rezervat e nxjerreshme nga shfrytezimi me nentoke, pjesa e trupit poshte horizontit +1740 (dysHEME e karrieres), do te jene:

$$R_n = 3560 \times 0.7 \times [(1-0.12)/(1-0.1)] = 2492 \text{ tone}$$

Per varferim 10% gjate shfrytezimit nentokesor, cilesia e mineralit ne dalje do te jete:

$$45\% \text{ Cr}_2\text{O}_3 \times 0.9 = 40.5\% \text{ Cr}_2\text{O}_3$$

Nga ky objekt, parashikohen rezerva te nxjerreshme, gjithesej, me siperfaqe e nentoke, rreth 9240 tone, me cilesi ne dalje 42.3% Cr₂O₃.

Menyra e shfrytezimit

Pas llogaritjeve te bera me siper, rezervat e nxjerreshme te mineralit nga dalja ne siperfaqe, deri ne horizontin +1740, jane rreth 6840 tone. Keto rezerva ndahen: dalja ne siperfaqe deri ne +1750, jane 2850 tone dhe +1750÷+1740, jane 3990 tone. Keto rezerva, nga ana jone, mund te quhen te sigurta. Per rezervat poshte +1740, te cilat sipas gjykimit teknik mund te llogariten, mbartin pasiguri, mbasi, megjithese, kemi nje trup xeheror me elemente te rregullt ne siperfaqe dhe te gjitha premiset te bejne te mendosh per vazhdimesine e tij, mund te ndodhe edhe degjenerimi i tij (ngushtim e hollim), deri ne varferim gjenetik.

Te tilla fenomene ne trupat e kromit, ne pergjithesi, dhe sidomos ne trupat e vendburimeve te masivit ultrabazik te Bulqizes, pjesa juglindore (Ternove, Pylli i Zi, Theken, Fushe Kalt, etj.), jane vertetuar. Gjithsesi, poshte +1740, llogarisim brenda parametrave te percaktuar te kerkim-zbulimit rreth 2400 tone rezerva te nxjerreshme. Projektimi dhe kryerja e shpenzimeve per venien ne levizje te tyre, perben nje rrisht per investitorin, ne rastin konkret, subjektin privat "DUSHI" Sh.p.k.

Nisur nga pozicioni i daljes ne siperfaqe te trupit xeheror, relievi, infrastruktura e zones, cilesia dhe trashesia e trupit, me synimin qe te prodhohet mineral me varferim minimal, humbje sa me te pakta dhe me sa me pak pluhur, pjesa +1760÷+1740, do te shfrytezohet me karriere. Nga llogaritjet paraprake, kjo sasi rezervash do te shfrytezohet me nje koeficient zbulimi rreth 4 m³ shkemb per 1 ton mineral.

Pjesa poshte +1740, ku per vete pozicionin e trupit dhe terrenin, do te duhen germime me te medha, koeficienti i zbulimit dhe gjatesia e transhese rriten ndjeshem, kemi preferuar menyren e shfrytezimit me nentoke. Duke pranuar shfrytezimin nentokesor te rezervave poshte +1740 (dysHEME e karrieres), krijojme kushte te favoreshme, qe nepermjet punimeve nentokesore qe do te kryhen ne galerine Nr.2 (+1711) e mbi te (paneli 1711÷1740), te sqarohet me mire situata gjeologjike, pra vazhdimesia e trupit ne renie dhe zhytje.

Shfrytezimi me qiell te hapur i pjeses +1760÷+1740

Kapaciteti nxjerres i minieres, regjimi i punes, ndrresa ne dite, dite ne muaj, ose vit. Grafiku i punimeve te zbulimit dhe grafiku i prodhimit per gjithe minieren

a. Kapaciteti prodhues

Prodhimi i realizuar nga shfrytezimi i ketij objekti ne zonen e kerkuar, do te kete si destinacion tregun e jashtem per eksport ose te brendeshem per prodhim ferrokromi. Per kete arsye, ne varesi te tregut te studjuar dhe te pritshem, duke patur parasysht dhe sasine e rezervave te

shfrytezueshme ne objekt, subjekti parashikon nje **prodhim vjetor kromi prej 2250÷2300 ton/vit.**

b. Regjimi i punes

Per realizimin e prodhimit te parashikuar, karriera do te punoje rreth 8 muaj ose 200 dite ne vit, 25 dite ne muaj, me nje ndrrese ne dite.

Per muajt e pare te vitit te pare te aktivitetit te saj, karriera do te punoje me nje intensitet me te larte per realizimin e prodhimit, riparimin e rruges dhe hapjen e transhese se siperme dhe sisteme te ndryshme.

c. Grafiku i zbulimit dhe prodhimit, koeficienti i zbulimit

Sasia e pergjitheshme e zbulimit te kesaj karriere eshte 27568 m³ dhe parashikohet te realizohet per 3 vjet. Zbulimi do te ece paralelisht me shfrytezimin. Ne shkallen +1750÷+1760, parashikohet rreth 12925 m³ zbulim dhe ne shkallen +1750÷+1740, rreth 14643 m³ zbulim. Sipas sasise se rezervave te nxjerrshme me karriere, prej 6840 tone, koeficienti i zbulimit llogaritet:

$$Kzb = Vsh/Rn = 27568/6840 = 4.03 \text{ m}^3/\text{ton mineral}.$$

Llogaritjet jane bere sipas vizatimeve Nr.2, 3, 4, 5, 6, 7.

Cdo vit, parashikohet te realizohet nje prodhim prej 2250 tone

$$\text{Volumi ditor: } 45\text{-}50 \text{ m}^3 \text{ zbulim} + \text{prodhim}$$

Volumi i pergjithshem i zbulimit prej 27568 m³, do te depozitohet poshte kuotes +1760, jashte kufijve te shfrytezimit, por brenda siperfaqes se kerkuar per leje shfrytezimi, ne te dy anet e transhese hyrese per ne karriere (vizatimi Nr.9).

Varianti i hapjes se karrieres, argumentimi dhe zgjedhja e tij

Ne studimin e variantit te hapjes se karrieres jane marre ne konsiderate:

- Kuota e poshtme e kufirit te rezervave +1730
- Kuota e siperme e kufirit te rezervave +1761÷1758 (dalja ne siperfaqe)
- Parametrat geometrike te zones se shfrytezimit
- Pjerresia mesatare me e madhe dhe me e vogel e siperfaqes se objektit dhe asaj jashte kufijve te tij
- Mundesia e lidhjes me rruge e pjeses se siperme te karrieres mbi +1750 nga ana verilindore.

Mbas marrjes ne konsiderate te faktoreve te mesiperme duke pasur parasysh se rruga egzistuese mbrin ne anen verilindore te objektit ne kuoten +1750, eshte bere studimi i variantit te hapjes se objektit, i cili rezulton ne disa riparime te vogla te rruges auto, te hapur para vitit 1990 nga forcat ushtarake, per te kryer punime mbrojtese ne kete zone, nga diga e “Liqenit te Sopeve” deri ne objekt, me gjatesi rreth 0.6 km. Aktualisht, kjo rruge edhe ne gjendjen e sotme eshte e perdorshme.

Sistemi i shfrytezimit, treguesit tekniko-ekonomike te tyre

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit, jane marre parasysh faktoret e meposhtem:

- Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterilit
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit

- Menyra e ngarkimit dhe transportit te mineralit te kromit ne brendesi te karrieres dhe jashte saj

Ngarkimi i sterileve te zbulimit ne sheshet e te dy shkalleve +1750 e +1740 parashikohet te kryhet me ekskavator ose varinski, me kapacitet kove deri 0.5 m^3 .

Bazuar ne sa me siper, sistemi i shfrytezimit qe parashikohet te perdoret, eshte i thjeshte me transport te sterilin jashte karrieres, ne distance nga 50 m deri ne 100 m. Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoren ne kete objekt, jane:

- Lartesia e shkalles se karrieres: 10 m
- Gjeresia e sheshit te punes: 6-10 m
- Kendi i skarpates se shkalles: 70°
- Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve: 3 m
- Kapaciteti ditor prodhim+zbulim: $40-50 \text{ m}^3$
- Mbartja dhe transporti: i mekanizuar.
- Rrezimi i shkembinjve rrethues dhe mineralit: me perdorimin e lendes plasese
- Rendimenti per dite pune efektive te punonjesve direkt zbulim+prodhim: $15-20 \text{ m}^3/\text{dp}$

Rradha dhe dejtimi i shfrytezimit dhe grafiket perkates

a) Rradha e shfrytezimit

Pas riparimeve te rruges deri ne kuoten e kryerjes se zbulimit, qe ne muajt e pare te fillimit te aktivitetit, ne pjesen e siperme te karrieres, pervec germimeve dhe sistemimeve te ndryshme, parashikohet te filloje dhe prodhimi i mineralit nga kuota +1758.

Radha e pergjitheshme e shfrytezimit do te jete nga lart-poshte, nga kuota +1760 ne +1740 m.

b) Drejtimi i shfrytezimit

Drejtimi i shfrytezimit te objektit do te jete pergjithesisht nga skaji juglindor i objektit drejt atij veriperendimor, duke pershkuar zonen nga nje ekstrem ne tjetrin dhe nga profili 1-1 drejt atij 3-3. Transhete do te zhvendosen nga juglindja ne veriperendim deri ne kufijte ekstrem te zones se shfrytezimit ose deri ne kufijte e shuarjes se shkalleve.

Sipas situates se zhvillimit te punimeve, gjate shfrytezimit mund te aplikohet dhe zhvendosja e ballit te transhese se zbulimit nga qendra per ne dy ekstremet gjatesore te zones se shfrytezimit ose shuarjes se shkalleve.

Orientimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izoipseve te terrenit, planimetrine e karrieres ne gjendjen perfundimtare.

Elementet e karrieres ne gjendjen perfundimtare te saj

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera do te kete formen e paraqitur ne piken c) te ketij projekti, me shtrirje juglindje-veriperendim, me parametrat e meposhtem:

1. Thellesia vertikale e karrieres: 30 m
2. Numri i shkalleve: 3
3. Gjeresia e karrieres ne plan ne pjesen e siperme te saj, ne sheshin +1760, do te jete: 130 m
4. Gjeresia ne sheshin e poshtem te karrieres (kuota +1740): 10 m

5. Gjatesia e karrieres ne pjesen e sipërme: 75 m
6. Gjatesia e karrieres ne pjesen e poshtme: 30 m
7. Kendi i shuarjes se shkalleve ne varesi te shtrirjes se karrieres eshte: 57-58°
8. Lartesia e shkalles: 10 m
9. Lartesia e fetes se shfrytezimit: 2-2.5 m ne te gjithë gjerësinë e shkalles
10. Siperfaqja e karrieres ne plan se bashku me transhete e hyrjeve: 3925 m²

Pasaportat e shpim-plasjes gjate zbulimit dhe ne frontin e prodhimit

Parashikimi i puneve te shpim-plasjes eshte bere duke patur parasysh faktoret e meposhtem:

- Domosdoshmerine e perdorimit te lendes plasese per rrezimin e shkembinjve rrethues dhe mineralit;
- Karakteristikat gjeomekanike te llojeve te ndryshme shkembore
- Volumi ditor ne m³ masiv, prej 45-50 m³

Ne varesi te faktoreve te permendur me sipër, per shfrytezimin e karrieres eshte parashikuar pasaporta e shpim-plasjes me bira te shkurtra minash. Shpimi i birave do te behet me cekic shpues pneumatik.

Parametrat e pasaportes se shpim-plasjes, do te jene si me poshte

- Lartesia e shkalle: 10 m
- Lartesia e nenshkalles: 2 m
- Gjatesia e bires: 2.2 ml
- Diametri i bires: 38-42 mm
- Kendi i skarpates: 70°
- Distanca nga bira ne bire: 1.5m
- Distanca nga buza e skarpates ne bire: 1.2m
- Vija e rezistences me te vogel: 2-2.2 m
- Ngarkesa e lendes plasese per bire: 1.8 kg
- Volumi maksimal i hedhur nga nje bire: 6 m³
- Konsumi specifik i lendes plasese: 0.30 kg/m³
- Birat do te jene vertikale ose te pjerrta sipas pjerrësisë se trupit, kur rrezohet minerali
- Numri i birave per realizimin e kapacitetit ditor: 9-10 cope

Per mbushjen e birave parashikohet te perdoret amonit malor, prodhim i uzines se Mjeksit, Elbasan ose dinamit.

Percaktimi i zonave te rrezikshme nga punimet e shpim-plasjes

Per pune te sigurte ne perputhje me Rregullat e Teknikes se Sigurimit per Punet me Lende Plasese, personeli teknik i karrieres eshte i detyruar te respektojë distancat e parrezikshme, te llogaritura me poshte:

a) Percaktimi i largesive te sigurta nga veprimi i vales goditese ne siperfaqe

Percaktimi i largesive te sigurta nga veprimi i vales goditese ne sipërfaqe eshte bere me formulën:

$$R_s = K_s Q^{0.5}, \text{ ku:}$$

R_s – Distance e sigurte nga vala goditese ne metra

K_s – Koeficient perpjestimor madhesia e te cilit varet nga kushtet e vendosjes se ngarkeses dhe nga karakteri i demtimit. Vlera e tij per rastin tone eshte marre $K_s=10$

Q – Sasia e L.P qe shperthen menjehere eshte pranuar $Q=18$ kg

Pas zevendesimeve:

$$R_s = 10 \times 18^{0.5} = 43 \text{ m}$$

b) Percaktimi i largesive sizmike te sigurta nga plasja

b.1. Percaktimi i largesise se sigurte sizmike sipas RTS “Per Punet me Lende Plasese ne Minera dhe Nafte” (botim i vitit 2002, faqe 179-192).

Percaktimi i largesise sizmike te sigurte nga plasja eshte bere me formulën e meposhtme:

$$R_s = \alpha k_s x Q^{1/3}$$

Q – Sasia e ngarkeses se LP qe shperthen menjehere, eshte pranuar $Q=18$ kg

R_s – Largesia prej vendit ku behet plasja ne m; zonat me rreze me te vogel se R_s jane zona te rrezikshme zonat me rreze me te madhe se R_s jane zona te parrezikeshme.

α – Koeficienti qe varet nga treguesi i veprimit te plasjes, per rastin tone $\alpha=1.2$

k_s – Koeficienti qe varet nga vetite e tokes ne themelet e objekteve qe ruhen. Per rastin tone vlera e tij $k_s=9$.

Pas zevendesimit do te kemi:

$$R_s = \alpha x k_s x Q^{1/3} = 1.2 \times 9 \times 18^{1/3} = 29 \text{ m}$$

b.2. Percaktimi i largesise sizmike ne varesi te shpejtesise se lekundjeve V_{max} ne mm/sek

Ne funksion te kushteve qe vendosin normat DIN dhe AFTES, te aplikueshme per te gjitha vendet e komunitetit Europian, eshte bere llogaritja e shpejtesise maksimale te lekundjeve nga shperthimi i L.P. me formulën e meposhtme:

$$V_{max} = k/(D/Q^{1/2})^{-1.8}, \text{ ku:}$$

V_{max} – Shpejtesite e lekundjeve, ne mm/sek

D – Distanca nga vendi i shperthimit, ne metra

Q – Sasia e L.P. qe shperthehet njeheresh, 18 kg

K – Koeficient qe merr ne konsiderate treguesit e masivit shkembor RQD RMR kompaktesine dhe shpejtesine e shperndarjes se vales lekundese ne m/sek. K merr vlerat 1200-6000 dhe eshte pa njesi.

Pas transformimeve ne formulën e mesiperme, duke marre ne konsiderate:

- $Q=18$ Kg
- RQD = 89-95%
- RMR – e vleresuar indirekt sipas metodikes se Barton, etj.
- Shpejtesine e perhapjes se vales (3000m/sek–5000m/sek), qe eshte pranuar 3000 m/sek

V_{max} e lejuar per ndertesa nje kat, me me konstruksion te zakonshem = 22.5 mm/sek

V_{max} e lejuar per ndertime te rendesishme = 8 mm/sek

Per sasine e shperthimit prej 18 kg, kjo distance do te jete 100 m.

c. Percaktimi i largesise se parrezikshme nga flakerimi i copave shkembore

- Permase dhe forma e zones se flakerimit te copave shkembore varet nga:
- Sasia e ngarkeses se lendes plasese ($Q_{max}=18$ kg)
- Menyra e vendosjes se ngarkeses me lende plasese (ne siperfaqe, ne toke dhe nentoke)
- Vlera e treguesit te veprimit te plasjes N
- Kendi i flakerimit te copave ne raport me horizontin
- Prania e pengesave natyrale mbrojtese qe frenojne perhapjen e copave shkembore
- Lloji i tokes, ku kryen punimet me lende plasese (ne rastin tone toka shkembore)

Duke marre parasysh te gjithë faktoret e permendur me siper, pozicionin aktual ku zhvillohen punimet ne raport me objekte te ndryshme dhe ne baze te “Rregullores se Teknikes se Sigurimit per Punet me Lende Plasese”, pranojme distancën e parrezikshme $D_s = 350$ m.

Argumentimi dhe zgjedhja e pajisjeve te shpimit, ngarkimit dhe transportit

Sic eshte premendur ne pjesen “zbulimi dhe prodhimi”, vellimi i pergjithshem i zbulimit dhe prodhimit ne vit do te jete rreth 9800 m³.

Vellimi ditor, duke pasur parasysh pune jo ritmike dhe nderprerjet per shkak te kushteve klimaterike, eshte pranuar 60-70 m³/dite.

Ne procesin e shfrytezimit te ketij objekti do te perdoren pajisje shpimi te tipit cekic dore dhe per kapacitetin ditor te zgjedhur, ne pune mjafton vetem nje cekic.

Per realizimin e ketij kapaciteti ditor, nevojitet vetem nje mjet ngarkimi me kohe te pjeseshme pune. Per transportin e mineralit dhe sterilit nga sheshet e karrieres ne sheshet e stokimit dhe depozitimit, nevojitet vetem nje mjet 5 tonesh, me kohe pune te reduktuar.

Zgjedhja e sheshit te depozitimit te sterileve dhe mineralit

Gjate kryerje se proceseve te zbulimit dhe atyre te prodhimit, parashikohet te veprohet si me poshte:

Per zbulimin:

Sasia e pergjitheshme e zbulimit per te gjithë karrieren parashikohet te kryhet ne 3 vjet.

Sasia e pergjithshme e zbulimit prej 27568 m³ do te depozitohet ne siperfaqe te perfshire midis kuotave +1750 dhe +1760, ne juglindje te siperfaqes se karrieres. Siperfaqja e depozitimit te sterileve eshte rreth 4500 m².

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Bashkia e Dibrës shtrihet në veri-lindje të Shqipërisë, në koordinatat gjeografike 41° e 53' dhe 20° e 34', në një territor me sipërfaqe 1,001 km². Peshkopia është qendra administrative dhe urbane e bashkisë dhe ndodhet në largësinë 44 km nga Lura, 36 km nga Kalaja e Dodës dhe 18 km nga pika kufitare e Bllatës. Territori është rural në më shumë se 91% të sipërfaqes së tij. Bashkia e Dibrës përbëhet nga një qytet (Peshkopia) dhe nga 141 fshatra, të cilat janë pjesë e 14

njësive administrative si: Lura, Zall-Reçi, Zall-Dardha, Selishta, Luzni, Muhurri, Arrasi, Fushë-Çidhna, Sllova, Kalaja e Dodës, Kastrioti, Tomini, Melani dhe Maqellara.



➤ Relievi

Në zonën ku kalon gjurma e projektit takohen pothuajse të gjithë tipat e klasifikimit morfogjenetik të relievit. Gjenden mjaft forma interesante relievi si: gryka, kanione, shpella, cirqe akullnajorë, fusha karstike etj. Mbizotërues është relievi kodrinor-malor. Konfiguracioni i relievit në rrethin e Dibrës është i larmishëm. Territoret me lartësi 300- 600 metër zënë 13.7 % të sipërfaqes së rrethit, lartësitë 600-1000 metër zënë 30 % të sipërfaqes, lartësitë 1000-2000 metër zënë 53.5 %, ndërsa pjesa tjetër prej 2.8 % zihet nga territori që shtrihet në lartësi mbi 2000 metër. Pra zona malore e Dibrës zë 56.3 % të territorit, ndërsa ajo fushore dhe kodrinore 43.7 % të saj. Vargjet e Lurës shtrihen midis luginës së Drinit të Zi në lindje, pellgut të Matit në perëndim, luginës së Sërriqes në veri dhe luginës së Zallit të Bulqizës në jug. Kanë drejtim veri-jug në një gjatësi prej rreth 75 kilometër dhe gjerësi që shkon nga 20 kilometër në jug në 30 kilometër në qendër. Formohen prej dy vargjesh paralele midis tyre, që në pjesën veriore kthehen drejt verilindjes. Lartësitë më të mëdha të tyre arrihen në pjesën qendrore me malin e Dejës (2246 metër) dhe Kunorën e Lurës (2121 metër).

➤ Gjeografia e zones

Objekti i zbuluar dhe bashke me te gjithë siperfaqja e kerkuar per leje dshrytezimi, vendoset ne nje terren te thyer kodrinoro-malor. Dalja e mineralit vendoset ne shpatin jugperendimor te Liqenit te Sopeve, ne nje reliev te qete, me pjerresi te bute e te pershkuar nga shume rruge e germime ushtarake te kryera qe para viteve 1990, cka bejne relativisht te lehte shkuarjen ne objekt.

➤ Popullsia, klima, infrastruktura e zones

Objekti, per te cilin kerkohet leje shfrytezimi, administrativisht perfshihet ne rrethin e Bulqizes dhe varet nga komuna e Martaneshit. Ne kete zone nuk ka qendra te banuara. Qendra me e afert e banuar eshte qyteti i Krastes, rreth 15 km larg dhe fshatrat e krahines se Martaneshit. Ne se do

te vendoset te punohet ne kete objekt, punetoret do te duhet te cohen nga Krasta me mikrobuz per ne vendin e punes.

Zona, ne te cilen ndodhet objekti, karakterizohet nga nje klime kontinentale, me dimer te gjate e te ftohte dhe vere te shkurter, te thate e shume te nxehte.

Dimri, i cili fillon ne fund te muajit Nentor dhe mbaron ne fund te muajit Mars, shoqerohet me rreshje te medha debore qe zakonisht e kalojne trashesine 1.5 m. Ne kete peridudhe 4-mujore rruget bllokohen dhe nuk punohet. Nisur nga pervoja shumevjecare e punes, ne zona te tilla me lartesi mbi +1600 m, planifikohet te punohet 8 muaj ne vit.

Objekti i kerkuar eshte afer me rrugen automobilistike Bater-Liqeni i Sopeve, rruge, e cila eshte ne gjendje te mire dhe qe shfrytezohet aktualisht nga shume subjekte te tjera private, qe kane aktivitet minerar ne kete zone (Lugu i Gjate–10 Korriku–Fushe Lope–Liqeni i Sopeve).

➤ **Ekonomia e zones dhe aktivitetet kryesore**

Megjithese zona ku vendoset ky objekt kromi nuk eshte e populluar, banoret e krahines se Martaneshit dhe qytetit te Krastes kane si aktivitet kryesor vetem minierat. Nje pjese e tyre jane te regjistruar si subjekte private dhe jane vetepunesuar, ndersa pjesa tjeter jane te punesuar. Gjendja ekonomike e tyre nuk eshte e mire. Kjo shpjegohet edhe me faktin, qe nje pjese e popullsisë se kesaj zone ka zbritur ne vende te ulta, si Tirane e Durres, ku edhe kushtet klimaterike jane me te favoreshme.

Pervec aktivitetit minerar, ne zone merren edhe me shfrytezimin e pyjeve, me pak me bujqesi, blegtori, tregeti dhe sherbime te tjera komunale.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

• **Ndikimet ne popullsi**

Ushtrimi i aktivitetit do te kryhet ne Objekti "Maja e Gjeprave", Galeria Nr. 3, Vendburimi "Liqeni i Sopave", Bater, Bulqize, Diber dhe ka nje largësi prej 2.2 km nga banesa me e afërt. Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete ndryshime ne popullsi. Numri i fuqise punetore pavaresisht se nuk eshte i madh, 13-15 eshte nje numer i cili mund te sigurohet nga vete zona per rreth subjektit. Kjo bazohet ne potencialin qe ka kjo zone per te siguruar punonjes te cilet jane te afte te punojne ne objekte minerare. Zona e Martaneshit eshte nje zone ne te cilen punimet minerare datojne mbi 50 vjet me pare e deri ne vitin 1992 banoret e kesaj zone kane qene burimi kryesor i fuqise punetore te minieres. Vec kësaj, ne afërsi te subjektit jeton nje komunitet shume punetore e i disiplinuar i cili i permbush plotesisht kerkesat per pune ne miniere.

• **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat qe krijohen jane si rezultat i makinerive qe perdorenper zhvillimin e proceseve

teknologjike, zhurma te tjera nuk ka gjate zhvillimit te aktivitetit.

- **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Nga gjenerimi i ketij aktiviteti nuk ka shkarkime ne ujera. Nga vrojtimet e bera ne galerite e minieres eshte vene re se ka prezence shume te ulet te ujrave kjo vjen si pasoj e mungeses se vijave ujembledhese (perrenjve). Kjo sasi e paket e ujrave ne miniere vjen si pasoj e reshjeve apo te shkrirejse se debores, por gjithmone jane ne sasi teper te vogel.

- **Ndikimet ne toke**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngurta te cilat te perbejne rrezik per ndotjen e tokes, te vetmet mbetje qe gjenerohen jane ato qe vijne nga aktiviteti personal i punonjesve te cilat drejtohen ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.

- **Ndikimet ne ajer**

Duke qene se kemi te bejme me nje aktivitet karriere dhe miniere, kemi nje gjenerim te pluhrave ne ajer por qe nuk shkaktojne ndotje te nje niveli shqetesues. Per ta evituar, here pas here subjekti ben sperkatje me uje te territorit.

- **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit, ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

- **Ndikimet ne perdorimin e tokes**

Aktiviteti ne fjale eshte i pajisur me nje leje minerare, dhe per kete arsye ne perfundim te shfrytezimit te kesaj siperfaqe toke, do kryhet rehabilitimin e saj. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne perdorimin e tokes, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar per kete qellim.

- **Ndikimet ne ekonomi**

Persa i perket ndikimeve ekonomike, ky aktivitet sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth per te rritur nivelin e tyre te jeteses.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Masat qe duhen marre per eleminimin/minimizimin e ndotjeve.

Ndikimi i mundshem	Masat e marra
1 Ndikimet ne toke (menaxhimi i mbetjeve sterile)	Nga kryerja e punimeve te zbulimit, per zbulimin dhe nxjerjen emineralit te kromit, del nje volum i konsiderushem sterile. Keto sterile transportohen me kamiona dhe depozitohen jashte kufijve te karieres ne sheshin e depozitimit, keto sterile perdoren per rehabilitimin e siperfaqeve te shfrytezuara. Persa i perket mbetjeve urbane te cilat jane mbetjet e gjeneruara nga stafi i punojsve keto do te grumbullohen ne vendet e percaktuar nga subjekti per tu derguar me pas ne vendet e percaktuara nga pushteti vendor.
2 Humbja e tokes per kullote	Siperfaqe e pergjithshme qe do te zeje objekti i shfrytezimit nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson ndonje kullote. Ne perfundim te shfrytezimit do te behet mbushje me sterile te hapsirave te krijuara nga kryerja e punimeve te zbulimit dhe te shfrytezimit. Hapsirat e krijuara ne karierat dhe miniera nga kryerja e punimeve te zbulimit dhe te shfrytezimit kryesisht do te mbushen me sterilet e depozitimeve qe gjenden ne vendburim, ndersa ne pjesen e siperme do te mbushen me toke produktive. Do te behet depozitimi dhe sistemimi dheut produktiv me trashesi rreth 60 cm mbi siperfaqet e mbushura me steril. Shfrytezimi i objektit nuk ze toka buke dhe prish pyje dhe kullota.
4 Ngjeshje e pjeseshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe te automjeteve te transportit si kamione etj.	Ngjeshja e tokes nga mjetet e punes gjate shfrytezimit si dhe nga levizja e mjeteve te transportit te mineralit dhe sterilit. Te cilat do te transportojne sterilet per ne sheshin e sterileve si dhe lenden e pare.
6 Vibracion si pasoje e shfrytezimit.	Do te jete nje vibracion normal teknologjik i cili duhet te jete i ndjeshem vetem ne zonen ku shfrytezohe.

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve negative ne ajer

Ndikimi i mundshem	Masat e marra
1 Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet, ngarkim transportit.	Saisa e gazeve e NOx dhe SOx qe do te shkarkohet eshte standart i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara. Mjetet jane te kolauduara dhe shkarkimet e kesaj natyre jane minimale.
2 Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes.	Objekti eshte i distancuar nga qendra e banuar, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operaconet e punes do te jene te limituara ne kohe. Do te punohet me nje turn.
3 Sasi pluhuri si pasoje e shfrytezimit te karrieres, pasi shfrytezimi brenda ne miniere nuk gjeneron pluhura ne ambientin e jashte saj dhe	Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojte kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle. Ne kohe te thate do te behet lagia e siperfaqes ku po punohet si dhe e rrugeve te qarkullimit te mjeteve.

qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit dhe sterilit.

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve negative ne uje

Ndikimi i mundshem Masat e marra

- | | | |
|---|---------------------|--|
| 1 | Shkarkimet e ujrave | Ne teknologjine e shfrytezimit me karriere siperfaqesore nuk perdoret uji. Ujrat e gjeneruar nga shfrytezimi ne miniere jane ne nje sasi shume te vogel gati te paperfillshme. |
|---|---------------------|--|

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve ne floren e zones

Ndikimi i mundshem Pasojat ne mjedis

- | | | |
|---|----------------------------|--|
| 1 | Shqetesim i flores ne zone | Siperfaqja e karrieres dhe minieres dhe perreth saj eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht dhe fauna eshte e varfer proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Nga shfrytezimi do te kemi largim te siperfaqes se tokes me bimesi, ne pergjithesi takohen shkurre dhe bime barishtore. Siperfaqja e prekur do te mbillet me bime lokale ne momentin kur te behet rehabilitimi i siperfaqes qe shfrytezohe. Rehabilitimi behet ne menyre progresive.
Rehabilitimi progresiv i sektorit te minieres konsiston ne mbjelljen e pemeve pereth objekteve siperfaqesore te minieres, hapjen e kanaleve per rreth ketyre objekteve me qellim parandalimin e futjes se ujrave siperfaqesore ne miniere. Edhe gjate viteve te zgjatjes se afatit te vlefshmerise se lejes minerare per 10 vjet, ne miniere do te vazhdoj qe te kryehet rehabilitim progresiv per gjelberimin e zones perreth objekteve siperfaqesore. |
|---|----------------------------|--|

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve ne peisazh

Ndikimi i mundshem Pasojat ne mjedis

- | | | |
|---|--|---|
| 1 | Ndikime ne peisazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti | Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime te pjerresise se terrenit dhe ato vizuale te peisazhit. Te cilat do te permiresohen ndjeshem me reabilitimin progresiv konkretisht aty ku punimet e zbulimit dhe te shfrytezimit jane ne kufi dhe nuk zhvillohen me tutje.
Ne reabilitimin e sektorit te minieres jane mbjell peme pereth objekteve siperfaqesore te minieres dhe gjate viteve te zgjatjes se afatit te vlefshmerise se lejes minerare per 10 vjet, ne miniere do te vazhdoj qe te kryehet rehabilitim progresiv per gjelberimin e zones perreth objekteve siperfaqesore. |
|---|--|---|

Masat e marra per menaxhimin e mbetjeve te ngurta

Ndikimi i mundshem Pasojat ne mjedis

- | | | |
|---|--|--|
| 1 | Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njezror | Kartona, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve.
Leter dhe karton- 20 01
Mbetje te biodegradueshme-20 01 08
Plastikat- 20 01 39
Keto mbetje do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga |
|---|--|--|

nga drejtuesit e shoqerise per tu derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.

Mbrojtia nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ **Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Jane punesuar punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Jane punesuar punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike instruktohen per rreziket ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit pajisen me mjete mbrojtese si dhe uniformat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.